



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1682/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Arena Trade” ShPK me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi&Lata” ShPK me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.305/22 të datës 26.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “Arena Trade” ShPK me seli në Fushë Kosovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.305/22 të datës 26.10.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.305/22 të datës 26.10.2023, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, ka refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Arena Trade” ShPK me seli në Fushë Kosovë. Në pikën II. Mbetet në fuqi aktvendimi me nr.01.3.2.2/2929/2019 i datës 24.11.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Ndërsa nën pikën III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e themeltë ankesa e paditësit “Arena Trade” ShPK, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomës së Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal KF.nr.305/22 i datës 26.10.2023 ashtu që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit “Arena Trade” ShPK, anulohet aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës nr. 01.3.2.2/2929/2019 i datës 24.11.2021. të obligohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit “Arena Trade” ShPK t’ia pranoj vlerën e transaksionit realisht të paguar për mallin lëndor sipas DUD-ve R-2567 të datës 06.02.2019, R-3214 të datës 13.02.2019 dhe R-5538 të datës 07.02.2019 dhe t’ia kthej mjetet e paguara më tepër

paditësit në emër të taksave doganore importuese në vlerë 4,700.54 euro, me kamatë vjetore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatë me datë 24.12.2021 e deri në pagesën definitive, ose të aprovohet si e themeltë ankesa e paditësit “Arena Trade” ShPK, prishet aktgjykimi Gjykatës Komerciale, Dhomës së Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal KF. Nr.305/22 i datës 26.10.2023 dhe çështja ti kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar me nr.01.3.2.2/2929/2019 të datës 24.11.2021 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, në pikën I. të dispozitivit, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë “Arena Trade” ShPK-Fushë Kosovë për rishqyrtimin e vendimeve R-2567/06.02.2019, R-3214/13.02.2019 të ZBD Interevropa dhe R-5338/07.02.2019 të ZBD Prishtina si të pa bazuara. Në pikën II. Mbeten në fuqi vendimi/Deklaratat Unike Doganore R-2567/06.02.2019, R-3214/07.02.2019 të ZBD Interevropa dhe R-5338/07.02.2019 të ZBD Prishtina. Në pikën III. Hudhet poshtë- kërkesa e subjektit në procedurë “Arena Trade” ShPK-Fushë Kosovë, për rishqyrtimin e vendimit R-2180/01.02.2021 të ZBD Interevropa, si e ushtruar jashtë afatit ligjor.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartë cekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 24.12.2021, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/2929/20190 i datës 24.11.2021 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, ne vështrim të nenit 44, par. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t’i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit A.nr.305/22 të datës 05.05.2023 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë konflikt administrativ me ekspertin financiare A.K.. Ekspertja

financiare në ekspertizën financiare të datës 23.05.2023, plotësim e ekspertizës të datës 06.10.2023 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se në bazë të kërkesës së gjykatës kemi bërë rishikimin e DUD-ave kontestues, kemi nxjerr diferencën e paraqitur për Doganë dhe TVSH dhe harmonizimin e transaksioneve bankare ndërkombëtare me faturat përcjellëse të mallit sipas DUD-ave kontestues. Kjo kronologji është arritur mbi bazën e dokumentacionit përcjellës të lëndës. Mbesë në tërësi pranë ekspertizës së punuar. Sipas aktvendimit kam pasur të bëjë një sqarim shtesë, andaj për diferencën e mjeteve që janë paguar më shumë kam kërkuar nga subjekti këtu paditësi barazimin e bërë në mes të tij dhe shitësit të mallit, dhe nga sqarimet që kam marr nga paditësi dhe dokumentacionin në shkresat e lëndës kam ardhur deri të konstatimi respektivisht sqarimi shtesë për secilin DUD kontestues e të cilat janë pasqyruar në plotësim të ekspertizës financiare. Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt tregtar - administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi i cili thekson se në rastin konkret përmes provave-urdhërpagesave bankare të aprovuara ka vërtetuar çmimin e vërtetë të paguar për mallin lëndor, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë kontest tregtar administrativ është jo i harmonizuar për të konstatuar se vërtetë paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor. Paditësi nuk ka arritur të paraqes pagesat për faturat kontestuese të mallit, edhe pse pagesat i referohen pro-faturave dhe jo faturave të mallit këtu paditësi nuk ka arritur të dëshmoj harmonizimin e këtyre pagesave bankare me faturat e mallit kontestues në kuptim të vlerës lartësisë së pagesës, tutje nuk ka arritur të dëshmojë se pagesat e realizuara më tepër në raport ne shumën sipas faturave të mallit kontestues a janë kthyer si të tilla apo janë përdorur në importet e tjera, pra nuk ka paraqitur notat e debitit dhe kreditit siç veprohet në marrëdhëniet ndërkombëtare të shkëmbimit të mallrave, në rastet kur ka pagesë më të lartë apo më të ulët se sa fatura e mallit. Këto fakte janë konstatuar si të tilla edhe nga ekspertja financiare e cila në seancën e datës 26.10.2023, përveç tjerash në pyetjen e gjykatës se : *në lidhje me tre DUD-at kontestues respektivisht pagesat e realizuara më tepër a janë përmbyllur me nota krediti/debiti e njëjta përgjigjet se : jo nuk kam hasur në nota krediti apo debiti me këto pagesa bankare.* Gjykata ka konstatuar se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuara nga paditësi, duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacionin jo të harmonizuar, e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtet të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 paragrafi 1 të LKA-së, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si

dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme edhe përmes ekspertizës financiare që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të konstatoj gjendjen faktike pasi që paditësi e ka dëshmuar me anë të provave materiale se vlera e deklaruar është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në kuptim të nenit 33 të KDAK-së, përkatësisht lidhur me çmimin e deklaruar të mallit lëndor ka një harmonizim të plotë ndërmjet çmimit për kilogram të deklaruar në kontratën e shitblerjes së mallit lëndor me çmimin për kilogram të deklaruar në faturë dhe pro faturë. Në këtë çështje përmes ekspertizës financiare është vërtetuar edhe baza edhe lartësia e kërkesëpadiës së paditësit në atë mënyrë që është konstatuar se paditësi në avans përmes transferit bankar e ka bërë pagesën e mallit lëndor në bazë të pro faturës. Po ashtu është konstatuar se çmimi/kg i deklaruar në kontratën e shitblerjes së mallit lëndor është i njëjtë me çmimin/kg të deklaruar në pro faturë dhe çmimit/kg të paguar. Këto pretendime kolegjive i kësaj gjykate nuk i aprovoj pasi konsideron se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase nga provat e administruara, gjykata nuk ka mundur që të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmojë provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të KDAK-së. Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka konstatuar gjendjen faktike kur ka theksuar se paditësi nuk ka arritur të paraqes pagesat për faturat kontestuese të mallit, edhe pse pagesat i referohen pro-faturave dhe jo faturave të mallit këtu paditësi nuk ka arritur të dëshmojë harmonizimin e këtyre pagesave bankare me faturat e mallit kontestues në kuptim të vlerës lartësisë së pagesës, tutje nuk ka arritur të dëshmojë se pagesat e realizuara më tepër në raport në shumën sipas faturave të mallit kontestues a janë kthyer si të tilla apo janë përdorur në importet e tjera, pra nuk ka paraqitur notat e debitit dhe kreditit siç veprohet në marrëdhëniet ndërkombëtare të shkëmbimit të mallrave, në rastet kur ka pagesë më të lartë apo më të ulët se sa fatura e mallit. Prandaj, Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vendosur kur i ka pranuar konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se nuk mund të veprohet sipas pretendimeve të paditësit që malli të vlerësohet sipas dokumentacionit të prezantuar pasi që paditësi nuk ka paraqitur dokumentacion të besueshëm dhe të kompletuar për të dëshmuar se çmimi i deklaruar është çmim real i paguar për mallin lëndor kontestues.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, gabimisht ka vërtetuar edhe të drejtën materiale më konkretisht

dispozitën ligjore nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë ashtu siç ka përcaktuar ajo, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret nuk ka pasur zbatim të gabuar pasi që rasti është trajtuar në mënyrë të rregullt dhe të drejtë në të gjitha fazat e vendimmarrjes, konform autorizimeve të dispozitave ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109 dhe të UA nr. 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Pretendimet ankimore se kontestet ndërmjet paditësit dhe Doganës së Kosovës është krijuar një praktik e konsoliduar gjyqësore në atë mënyrë që nga gjykata e shkallës së parë janë aprovuar kërkesëpaditë e paditësit dhe të njëjtat vendime janë vërtetuar edhe nga Gjykata e Shkallës së Dytë, në këto rrethana vlerëson se vendosja në mënyra të ndryshme e çështjeve të njëjta, cenon rëndë sigurinë juridike të palëve. Kolegji, ka vlerësuar provat e bashkangjitura ankesës së paditësit dhe ka vërejtur se çështja në këtë konflikt administrativ tregtar dallon nga çështjet tjera të paraqitura dhe nga aktgjykimet e mëhershme, për shkak se këtu kemi të bëjmë me pagesën më të lartë të çmimit të mallit lëndor kontestues e cila nuk është dëshmuar nga paditësi sipas faturave të mallit kontestues se mjetet e paguara më tepër a janë kthyer si të tilla apo janë përdorur në importet e tjera, pra nuk ka paraqitur notat e debitit dhe kreditit siç vepohet në marrëdhëniet ndërkombëtare të shkëmbimit të mallrave.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes gjen se Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka gjetur fakte të bazuara që argumentojnë me prova konkrete, pagesën për blerjen e mallit lëndor. Sepse, paditësi nuk ka prezantuar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se çmimi i deklaruar është çmim real i paguar për mallin lëndor kontestues. Kolegji vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor në bazë të metodës së 6 të vlerësimit në pajtim me nenin 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, përkatësisht në bazë të dhënave të disponueshme lidhur me vlerën e mallit, çmimet e marra nga Dosja e Vlerës. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kolegji i kësaj gjykate gjen se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat ligjore të nenit 43 paragrafi 1 dhe 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1682/23, me datë 16.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami